



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L-040, neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe neneve 14 dhe 16 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1

Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në këtë përbërje:

1. **Shpejtim Bulliqi**, Kryetar i Komunës, Kryesues i Këshillit
2. **Nijazi Jashari**, Komandant i Stacionit të Policisë - në Podujevë
3. **Mensur Hoti**, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame - Podujevë
4. **Shefki Selmani**, përfaqësues i kishës Protestante-Podujevë
5. **Xhafer Ademi**, përfaqësues i komunitetit ashkali
6. **Enver Rama**, përfaqësues i komunitetit rom
7. **Sevdie Mustafa**, përfaqësuese e komunitetit egjiptian
8. Kryesuesi/ja i/e Komitetit për Komunitete
9. **Naima Podvorica**, zyrtare për barazi gjinore
10. **Avni Fetahu**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit
11. **Nazif Sheqa**, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit - Podujevë
12. **Edolind Vishaj**, përfaqësues i FSK-së
13. **Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Kërpimëh
14. **Nuhi Selimi**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Orllan
15. **Rizah Muqolli**, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
16. **Bahri Selimi**, përfaqësues i Emergjencave Civile
17. **Liman Zeqiri**, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, Podujevë
18. **Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta

Neni 2

Këshilli themelohet në mandat te njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - KKSB.

Neni 4

1. Për punën e tyre anëtarët e KKSB-së paguhën nga Buxheti i Komunës, konform Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 për anëtarët e KKSB-së për pjesëmarrje në takime dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, në shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Kompensimi për pjesëmarrje në takimet e KKSB-së bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 5

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-016/01-0030693/22
Podujevë, datë: 29 prill 2022

